



PARTIA E DREJTËSISË

DEKLARATË POLITIKE

Partia e Drejtësisë si parti politike e qendrës, e mbështetur në konceptet politike të demokracisë progresive konservatore, social liberalizimit dhe social demokracisë artikulon interesat gjenuine të qytetarëve për shtet të pavarur dhe demokratik të Kosovës, të integruar në bashkësin europiane dhe në Nato.

PD konsideron se sigurimi i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut me dispozita kushtetuese dhe ligjore, pa asnjë lloj të diskriminimit, përfshirë lirinë e plotë të ushtrimit të identitetit fetar në institucionet publike dhe të drejtën e arsimimit fetar në shkolla, paraqet themel për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar. Partia e Drejtësisë mbështet fuqizimin e unitetit të vlerave të identitetit kombëtar, europian dhe kulturorë shpirtërorë të qytetarëve të vendit dhe vendosjen e tyre në themelet e politikave publike shtetërore.

Prishtinë

22.08.2017